

VENDIM
Nr. 360, datë 16.6.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 543, DATË 29.9.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMET E
LEGALIZUARA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 543, datë 29.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara”, anulohet kompensimi për pasurinë nr. 14/207, në zonën kadastrale 8601, Vlorë.

2. Ngarkohen Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama